


Prindërimi gjatë COVID-19

Të nxënit përmes lojërave

Miliona fëmijë po përballen me mbylljen e shkollave dhe izolimin në shtëpitë e tyre. Kjo këshillë lidhet me të nxënit përmes lojërave, çka mund të jetë një proces argëtues për të gjitha moshat!

Llojet e lojërave

- > Ka qat shumë lloje të ndryshme lojërash që mund të jenë argëtuese dhe edukative
- > Gjuhët, numrat, objektet, teatri dhe lojërat muzikore u japin fëmijëve mundësinë të eksplorojnë dhe të shprehin veten në mënyrë të sigurt dhe argëtuese



Tregimi i historive

- > Tregojuni fëmijëve një histori nga fëmijëria juaj
- > Kërkojuni fëmijëve tuaj t'ju tregojnë një histori
- > Krijoni së bashku një histori duke filluar me 'Na ishte një herë...'. Çdo person i shton historisë një fjali të re
- > Aktroni një histori ose film të preferuar; madje, fëmijët më të rritur mund të udhëzojnë fëmijët më të vegjël, duke mësuar kështu parimin e përgjegjësisë

Ndryshoni objektin!

- > Artikujt e përditshëm shtëpiakë, si fshesat, lecatat për dysheme ose shajet mund të shërbejnë si objekte argëtuese për lojëra
- > Vendosni një objekt në qendër të dhomës dhe sa herë që dikush ka një ide, ai/a jo del në qendër dhe u jep të tjerëve të dhëna për objektin e menduar
- > Për shembull, fshesa mund të shndërrohet në një kalë, mikrofoni, madje edhe në një kitarë!

Lojëra me lëvizje


- > Krijoni një koreografi vallëzimi për këngët e preferuara të fëmijëve tuaj. Personi i parë bën një lëvizje vallëzimi dhe të gjithë të tjerët e kopjojnë. Roli i drejtuesit merret nga të gjithë me radhë
- > 'Sfidoni' se kush mund të arrijë të prekë më shumë herë gishtat e këmbëve; kërcime me krahët dhe këmbët e hapura, prekja e gishtave të këmbës me krahun lart, preket e gishtave të këmbëve për një minutë
- > 'Imitoni' njëri-tjetrin: shprehjet e fytyrës, lëvizjet, tingujt. Njëri mund të fillojë si drejtues dhe më pas të ndërrojë rolet. Provojeni pa drejtues!
- > Kërcimi me ngjirje: Luani muzikë ose dikush mund të këndojë një këngë ndërsa të tjerët kërcen. Kur muzika ndalon, të gjithë duhet të ngrihen në vend. Personi i fundit që ndalon së kërcyeri, bëhet pjesë e jurisë për raundin e radhës
- > Kërcimi i kafshëve: Një lojë e ngjashme me atë të lartpërmenduar, por kur muzika ndalon, thoni emrin e një kafshe dhe të gjithë duhet të imitojnë kafshën e kërkuar

Loja e kujtesës

- > Personi i parë thotë 'Kur izolimi nga COVID-19 të përfundojnë, unë do të...(p.sh.: shkoj në park)'
- > Personi i dytë plotëson fjalinë e parë: 'Kur izolimi nga COVID-19 të përfundojë, unë do të shkoj në park dhe...(p.sh.: do të vizitoj shoqen/shokun tim të ngushtë)'
- > Çdo person plotëson fjalinë paraardhëse, duke menduar kështu të gjitha aktivitetet argëtuese që mund të bëhen pas përfundimit të izolimit nga COVID-19

Të kënduarit

- > Fëmija juaj mund të zhvillojë gjuhën përmes këndimit të këngëve
- > Luani ose këndonin një këngë dhe personi i parë që gjen titullin e saj, bëhet drejtuesi i ardhshëm
- > Krijoni një këngë për larjen e duarve ose distancimin fizik. Shtoni lëvizje kërcimi!



Për më shumë informacion, klikoni lidhjet e mëposhtme:

KËSHILLA NGA OBSH-JA

KËSHILLA NGA UNICEF-I

GJUHË TË TJERA

BAZUAR NË FAKTE